



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	07-12-2023	3	viti god year
Organ./Njesia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHCK	7352/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1331/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1331/2023 të datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit me numër nr.01-111/01-0121354/23 të datës 04.09.2023 në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.1331/2023 të datës 25.10.2023, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës me datë 23.10.2023 ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është pranuar me datë 25.10.2023 me numër të protokollit 6685/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit me numër nr.01-111/01-0121354/23 të datës 04.09.2023, përmes të cilit vendim refuzohet ankesa e datës 23.08.2023, lidhur me përzgjedhjen dhe caktimin e Ud. Drejtorit të Shkollës Muharrem Kastrati në SHFMU "Brigada 125" Medvec.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6685/2023 të datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit me numër nr.01-111/01-0121354/23 të datës 04.09.2023; Vendim i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prizrenit me numër nr.1513 i datës 18.08.2023; Autorizim nga H.K. për G.GJ. i datës 05.10.2023; Ankesa e ankuesit drejtuar Komisionit të Ankesave në Komunën Prizrenit i datës 23.08.2023; Pliko me numër R5448568 i datës 23.10.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Ankuesi me datë 25.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit me numër nr.01-111/01-0121354/23 të datës 04.09.2023, përmes të cilit vendim refuzohet ankesa e datës 23.08.2023, lidhur me përzgjedhjen dhe caktimin e Ud. Drejtorit të Shkollës Muharrem Kastrati në SHFMU "Brigada 125" Medvec.

Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit N.06/L-114 për Zyrtarët Publik (që kanë qenë në fuqi) përkatësisht me nenin 2 është përcaktuar se; "...2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa në nenin 2 paragrafi 4 po të këtij ligji është përcaktuar se : Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës dhe bazuar në legjislacionin e potencuar si më lartë konstatoi se pozita në të cilën ka aplikuar ankuesi për pozitën "Drejtor" hynë në kategorinë e nëpunësve të Shërbimit Publik, ndërsa në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me faktin se konstaton jo kompetencën në këtë lëndë përkatësisht ankesë dhe ndërlidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësve të shërbimit publik, edhe përkundër faktit se ankuesi ka qenë i informuar lidhur me ushtrimin e mjeteve juridike me rastin e nxjerrjes së vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit me numër nr.01-111/01-0121354/23 të datës 04.09.2023, përmes të cilit vendim refuzohet ankesa e datës 23.08.2023, i njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 74 paragrafin 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se: 5. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej


"pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente. Si rrjedhojë e kësaj me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill i njëjti është drejtuar gabimisht pasi që me rastin e nxjerrjes së vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prizrenit me numër nr.01-111/01-0121354/23 të datës 04.09.2023, ankuesi ka qenë i informuar lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1331/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

